

GJYKATA E QARKUT GJILAN

P.Pr.nr. 3/2011

17 janar 2011

Gjyqtari i Procedurës Paraprake i Gjykatës së Qarkut Gjilan, Gjyqtari Penal i EULEX-it në Nivelin e Gjykatës së Qarkut Gianfranco Gallo, duke vepruar sipas kërkesës për Urdhër për Kontroll të paraqitur në Gjykatën e Qarkut në Gjilan më datën 13 janar 2011 nga Zyra e Prokurorisë Speciale e Republikës së Kosovës (tash e tutje ZPSRK) dhe e pranuar nga Gjyqtari i Procedurës Paraprake të EULEX-it më datën 13 janar 2011, duke kërkuar nga Gjyqtari i Procedurës Paraprake të lëshoj urdhër për kontroll të objektit afarist – në lëndën penale kundër:

1.

Emri	Hatixhe
Mbiemri	Daku
Emri i babait	Islam
Data e lindjes	30.7.1959
Vendi i lindjes	Perlepnica, Komuna Gjilan
Gjinia	femrore
Adresa	Rr.Dardanija 2, Nr. 6/8, Gjilan
Kombësia	----
Nënshtetësia	----
Vendndodhja	----
Nr.i letërnjoftimit	----

2.

Emri	Qemajl
Mbiemri	Mustafa
Emri i babait	-----
Data e lindjes	8.4.1960
Vendi i lindjes	Malishevë, Komuna Gjilan
Gjinia	mashkullore
Adresa	Mbretresha Teutë Prishtinë
Kombësia	---
Nënshtetësia	---
Vendndodhja	---
Nr.i letërnjoftimit	---

sepse ekziston një dyshim i bazuar që ata kanë qenë të përfshirë në kryerjen e veprave penale në vijim, të cilat ndiqen *sipas detyrës zyrtare (ex officio)*:

1. Shpërdorim i Detyrës Zyrtare apo Autorizimit në kundërshtim me nenin 339, paragrafi 1 dhe 3 i Kodit Penal të Kosovës dhe i dënueshëm me burgim prej një deri në tetë vite.

Pas shqyrtimit të kërkesës së prokurorit dhe në pajtim me nenin 240 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), lëshon si në vijim:

URDHËR

Për kontroll të objekteve të kompanive në vijim:

- 1) **Kompania TALI Sh.p.k.:** Numri i Regjistrimit të Biznesit 70166508, Kompani me Përgjegjësi të Kufizuar, adresa: Kosovë, Gjilan, Rr. e Bujanovcit P,n., pronar Florim Zuka, Nr.i letërnjoftimit 2012672007.
- 2) **Kompania MAGISTRALJA, N.N.T.:** Numri i Regjistrimit të Biznesit 7033943, Ndërmarrje e Biznesit Personal, adresa: Kosovë, Gjilan, Popovicë II/1, me pronar Selami Pireva, Nr. letërnjoftimit 1005438990.

Të bëhet kontrolli në çdo objekt, dhe nëse gjendet, të konfiskohet përkohësisht:

- a) Çdo dokument që ka të bëjë me tenderët Gi 651 09 042 521 dhe Gi 651 09 032 521,
- b) Dokumentet dhe çdo gjë tjetër personale dhe/apo korrespondencën e biznesit ndërmjet kompanive dhe të pandehurve,
- c) Kompjuterët, laptopët, pajisjet USB, mjetet tjera të ngjashme, dhe telefonat celular, të cilët përdoren për ruajtje të të dhënave elektronike.

Gjatë kryerjes së kontrollit, zyrtarët nuk do të konfiskojnë objektet e përmendura në nenin 248 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK).

Koha e kontrollit duhet të jetë ndërmjet orës 06:00 dhe 22:00 brenda 48 orëve nga momenti i lëshimit të urdhrit. Nëse urdhri për kontroll nuk mundet të sigurohet me kohë, kontrolli gjithashtu mundet të kryhet pas orës 22:00 nëse plotësohen kushtet e nenit 241, paragrafi 2 i KPPK-së.

Urdhër kontrolli ekzekutohet nga policia gjyqësore brenda 48 orëve të lëshimit të urdhrit.

Policia gjyqësore e EULEX-it ZNJKH duhet të veproj sipas neneve 241 deri në 252 (përfshirë këtë) të KPPK-së dhe në veçanti, të mbaj raporte të sakta dhe adekuate të veprimeve të ndërmarra në ekzekutim të urdhrit.

Urdhri planifikohet dhe ekzekutohet në pajtim me strategjinë e vendosur nga Policia Gjyqësore. Ky veprimi hetimor do t'i besohet Robert Gricnik, ZHNJK.

Arsyetim

Më datën 13.1.2011 Gjykata e Qarkut Gjilan pranoi kërkesën e PSRK-së për urdhër kontroll për kompanitë e sipërpërmendura sepse ka dyshim të bazuar që të pandehurit Hatixhe Daku dhe Qemajl Mustafa kanë kryer veprat penale të përmendura në kërkesë.

Sipas kërkesës së PSRK-së dokumentet e konfiskuara më herët nga Zyra Komunale në Gjilan gjatë një hetimi tjetër mund të tregonte që kishte pasur shkelje të procedurave të prokurimit. Inteligenca ka marrë sugjerimin që të pandehurit e përmendur më lartë kanë ditur që procedurat e tenderit dhe prokurimit e kryera nga zyra e prokurimit në Gjilan nuk ishin në pajtim me procedurat e tenderimit të caktuara me ligj dhe se disa nga procedurat kanë qenë jo të ligjshme. Në tenderët e përmendur në kërkesë (dhe në veçanti në tenderët që kishin numrat Gi 651 09 042 521 dhe Gi 651 09 032 251) disa kompani kanë bërë oferta më të mira sesa ato dy kompani të cilat kanë fituar tenderët dhe në bazë të këtij urdhri.

Gjyqtari i Procedurës Paraprake, pas shqyrtimit të kërkesës, konstaton që ka dyshim të bazuar që:

1) Hatixhe Daku dhe Qemajl Mustafa kanë kryer veprën e shpërdorimit të Detyrës Zyrtare dhe të Autorizimit ndërmjet vitit 2007 dhe 2010 në Gjilan.

Në kërkesë përmenden që dy kompanitë e përmendura më lartë kanë qenë të përfshira në tenderë të dyshimtë më parë. Pastaj është e dyshimtë që pa marrë parasysh që kompanitë e tjera që kanë bërë oferta më të mira, kompanitë Tali dhe Magistralja kishin fituar tenderet siç u përmendet më lartë..

Gjyqtari i Procedurës Paraprake konstaton që pozita zyrtare e të pandehurit si drejtues i prokurimit në komunën e Gjilanit dhe si kryetar i Komunës së Gjilanit krijon dyshim të bazuar që ata duhet të kenë qenë të vetëdijshëm që procedurat e prokurimit të kryera nga zyra e prokurimit të Gjilanit, nuk ishin në përputhje me procedurat e tenderimit të përcaktuara me ligj dhe se disa nga procedurat kanë qenë jo ligjore.

Prandaj, bazuar në kërkesën e prokurorit; duke e njohur ekzistimin e dyshimit të bazuar të përmendur më lartë kundër të dyshuarve të cekur më lartë; duke e pasur parasysh që kontrolli i kërkuar për kompanitë e sipërpërmendura është i nevojshëm të mbrojtë dëshminë e veprës penale apo të konfiskoj objektet/gjësendet e caktuara të cilat nuk mund të mbrohen apo të merren pa kontroll dhe ka gjasa shumë të mëdha që një dëshmi e tillë apo gjësende të jenë në objektet apo pronën që do të kontrollohet, dhe pasi që kërkesa e prokurorit i plotëson kushtet ligjore sipas nenit 240 të KPPK-së;

Është vendosur si në dispozitiv të këtij urdhri.

Urdhri aktual është lëshuar në pesë (5) kopje identike origjinale.

Gjilan, 17 janar 2011 në ora 12:00.

Gjyqtari i Procedurës Paraprake
Gjyqtari Penal i EULEXit në Nivel të Gjykatës së Qarkut
Gianfranco Gallo



DISTRICT COURT OF GJILAN/GNJILANE

P.Pr.nr. 3/2011

17 January 2011

The Pre-trial Judge of the District Court of Gjilan/Gnjilane, EULEX Criminal Judge at the District Court level Gianfranco Gallo, acting upon the Application for Search Order filed at the District Court of Gjilan/Gnjilane on 13 January 2011 by the Special Prosecution Office of the Republic of Kosovo (hereafter SPRK) and received by EULEX Pre-trial Judge on 13 January 2011, requesting the Pre-trial Judge to issue an order for search of business premises – in the criminal case against:

1.

Name	Hatixhe
Surname	Daku
Father's name	Islam
Date of Birth	30.7.1959
Place of Birth	Perlepnica, Gjilan municipality
Gender	female
Address	Dardanija 2 Street, No. 6/8, Gjilan
Nationality	n/a
Citizenship	n/a
Whereabouts	n/a
ID number	n/a

2.

Name	Qemajl
Surname	Mustafa
Father's name	n/a
Date of Birth	8.4.1960
Place of Birth	Malishevo, Gjilan municipality
Gender	male
Address	Mbretresa Teute Prishtina
Nationality	n/a
Citizenship	n/a
Whereabouts	n/a
ID number	n/a

because there is a grounded suspicion that they have been involved in the commission of the following criminal offences, which are prosecuted *ex officio*:

1. **Abusing Official Position or Authority** in violation of Article 339 paragraph 1 and 3 of Criminal Code of Kosovo and **punishable by a term of imprisonment of one to eight years.**

After having reviewed the prosecutor's application and pursuant to article 240 of the Kosovo Code of Criminal Procedure (KCCP), issues the following:

ORDER

For the search the premises of the following companies:

- 1) **Company TALI Sh.p.k.:** registration business number 70166508, Limited liability company, address: Kosovo, Gjilanë e Bujanovcit P.n., owner Florim Zuka, ID number 2012672007.
- 2) **Company MAGISTRALJA, N.N.T.:** registration business number 7033943, Personal Business Enterprise, address: Kosovo, Gjilanë, Popovic II/I, owner Selami Pireva, ID number 1005438990.

To search for in each premises, and if found, to temporarily confiscate:

- a) Any documents related to tenders Gi 651 09 042 521 and Gi 651 09 032 521,
- b) Documents and any other personal and/or business correspondence between the companies and the defendants,
- c) Computers, laptops, USB sticks, other comparable devices, and mobile phones, which are utilized to store electronic data.

While conducting the search the officers shall not confiscate objects mentioned in the article 248 of the Kosovo Code for Criminal Procedure (KCCP).

Time of search should be between 06:00 and 22:00 hours within 48 hours from the moment the order is issued. If the search order cannot be obtained in time, the search could also be carried out after 22:00 hours if the requirements of Article 241 paragraph 2 KCCP are met.

The search order shall be executed by the judicial police within 48 hours of the issuance of the order.

The Judicial Police EULEX OCIU should act pursuant to Articles 241 to 252 (inclusive) of the KCCP and in particular, maintain accurate and adequate reports of the actions undertaken in the execution of the order.

The Search shall be planned and executed in accordance with strategy decided by the Judicial Police. This Investigating Action shall be entrusted to Robert Gricnik, OCIU.

Reasoning

On 13.1.2011 the District Court of Gjilan/Gnjilane received SPRK's application for the order for search for the aforementioned companies because there is grounded suspicion that defendants

Hatixhe Daku and Qemajl Mustafa have committed the criminal offences mentioned in the application.

According to the SPRK's Application documents seized previously from the Gjilan Municipal Office during another investigation could show that there had been breaches of procurement procedures. Intelligence received suggest that the above named defendants knew that tender and procurement procedures done by the Gjilan procurement office were not compliant with tender procedures set out in the law and that some of the practices were illegal. In tenders mentioned in the Application (and in particular in the tenders bearing the numbers Gi 651 09 042 521 and Gi 651 09 032 521) several companies have made better offers than the two companies winning tenders and subject to this order.

The Pre-Trial Judge, after reviewing the application, finds that there is grounded suspicion that:

1) Hatixhe Daku and Qemajl Mustafa have committed the offence of **Abusing Official Position or Authority** between 2007 and 2010 in Gjilan.

In the Application it is mentioned that two companies mentioned above have been involved into dubious tenders before. Moreover it is suspicious that notwithstanding other companies have made better offers, the companies Talia and Magistralja had won the tenders above indicated.

The Pre-Trial Judge finds that the defendant's official position as a head of procurement at Gjilan Municipality and as a Mayor of Gjilan creates grounded suspicion that they must have been aware that the procurement procedures made by the Gjilan procurement office were not compliant with tender procedures set out in the law and that some of the practices were illegal.

Therefore based on the prosecutor's application; having recognized the existence of the above mentioned grounded suspicion against the defendants above mentioned; considered that the search for above mentioned companies requested is necessary to preserve evidence of a criminal offence or to confiscate specific objects which cannot be preserved or obtained without the search and there is a sound probability that such evidence or objects are in the premises or property to be searched, and since prosecutor's application meets the legal requirements as per article 240 KCCP;

it has been decided as in the enacting clause of this order.

The present order has been issued in five (5) original identical copies.

Gjilan/Gnjilane, 17 January 2011 at 12:00 hrs

The Pre-trial Judge
EULEX Criminal Judge at District Court Level

Gianfranco Gallo

